

KONTRATE PER SHITJE KUOTE

Sot ne daten ..21.02.2000 para meje noteres Adelina Panajoti u paraqiten personalisht palet : --

SHITES : Hasan Laba , i biri i Lulos , dtl. 1961 , lindur ne Vlore e banues ne Fier , njohur nga leternjoftimi me nr. UG 416862 ; -----

BLERES : Diana Labo , i bija e Nesimit , dtl. 1970 , lindur e banues ne Fier , njohur nga pasaporta me nr. 0268110 ; -----

te dy palet madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar , te cilet me deklaruan : ---

Une shitesi Hasan Laba jam ortak i vetem i sh.p.k. " COLOMBO " me qender ne Fier , te regjistruar prane Gjykates se rrethit Tirane me nr. 9826 date 21.03.1995 dhe nr.9826/1 date 03.02.1998 . Vlera ime e kapitalit ne kete shoqeri eshte ne masen 100 % dhe ne leke kap shumen prej 10.000.000 leke. Kete pjese te kapitalit une jam dakort tja shes Diana Labo ne shumen prej 10.000.000 leke , shume te cilen ma ka dhene njeheresh ne dore jashte kesaj zyre noteriale dhe qe nga ky cast une heq dore vullnetarisht nga shoqeria si dhe nga detyra e administratorit te saj . -----

Une bleresi Diana Labo kam blere nga shitesi Hasan Laba kuotat ne masen 100 % , me vlere 10.000.000 leke qe ai kishte ne shoqerine " COLOMBO " sh.p.k. dhe meqenese kete shume ja kam likuiduar teresisht njeheresh ne dore jashte kesaj zyre jam dakort qe te jem une ortake e vetme e kesaj shoqerie .-----

Me nenshkrimin e kesaj kontrate asnjeri prej nesh nuk ka pretendime ndaj njeri tjetrit. Hasan Laba nuk ka asnje te drejte ndaj kesaj shoqerie , sikunder nuk ka edhe asnje detyrim ndaj saj apo te treteve .-----

Ky akt pasi u redaktua prej meje noteres ju lexua paleve , te cilat pasi e degjuan dhe e miratuan ne teresi aktin , e nenshkruan ate ne prezencen time . -----

Akti nenshkruhet edhe nga une noterja .-----

SHITESI

BLERESI

HASAN LABA
.....
Has.

Diana Labo
.....
Diana Labo

